

*Fjalori i terminologjisë tekniko-shkencore*, 9 Terminologjia e Elektroteknikës (shqip-rusisht-frengjisht), Bot. i Sektorit të Terminologjisë të Institutit të Historisë dhe të Gjuhësisë (Universiteti Shtetëror i Tiranës), Tiranë, 1963, 160 fq.

Dalja në dritë e një vargu fjalorësh terminologjikë është një dëshmi bindëse, se leksikografia jonë ka hyrë në një etapë të re, kur ajo nuk është më një mbledhëse e regjistruese e thjeshtë e leksikut të shqipes, por po thotë edhe fjalën e saj, merr pjesë në drejtimin dhe rregullimin e zhvillimit të leksikut dhe në pasurimin e tij. Çdo fjalor i ri terminologjik mund të vlerësohet si një hap përpara, si një sukses i ri pikërisht në këtë drejtim.

"Terminologjia e elektroteknikës" është vëllimi i nëntë nën titullin e përbashkët "Fjalor i terminologjisë tekniko-shkencore". Fjalori përmban 2291 terma të përkthyer në rusisht e frengjisht, pajisur me indeksin përkatës për të dyja gjuhët; është botuar në një format të përshatshëm për përdorimin praktik.

Vlera e këtij fjalori përcaktohet në radhë të parë nga fakti që ai është *i pari fjalor terminologjik në këtë fushë* për gjuhën shqipe. Dalja e tij në dritë do të ndihmojë shumë njësimin e terminologjisë, që të arrihet përdorimi i njëjtë i termave si nga pedagogët, studentët e përkthyesit, ashtu dhe nga inxhinjerët, punonjësit e prodhimit e të administratës. Aq më e madhe del në dukje kjo vlerë, po të shqyrtohet përmbajtja e fjalorit. Nga njera anë, ai është një hap me rëndësi në pasurimin e terminologjisë, duke përfshirë jo vetëm termat që prej kohe janë përdorur, por edhe ato që ndjehen të nevojshme sot dhe do të kërkohen nesër, për shkak të zhvillimit të vrrullshëm të ekonomisë sonë, të paisjes së saj me teknikë gjithnjë e më moderne dhe të zhvillimit të studimeve tona e të përgatitjes së kuadrove të reja.

Nga ana tjetër, dhe kjo është më e rëndësishmja, fjalori përbën një kontribut të ri për terminologjinë shqipe, për një terminologji që çfrytëzon sa më gjerë fondin leksikor të shqipes dhe elementët e modelet e saja të fjalëformimit. Nga një numurim i përafërt del se 20% e termave janë thjesht shqip, nga brumi vetiak i shqipes; internacionalizmat zenë afër 18% të termave, ndërsa 40% e tyre janë terma të përbëra nga një pjesë thjesht shqipe dhe nga një pjesë prej fjalësh të huaja, të asimiluara në shqipen. Rreth 10% e atyre që mbeten janë fjalë të ndërtruara sipas modeleve të shqipes dhe me afiks shqipe. Kështu që mbi 70% të fjalorit e përbëjnë fjalët shqipe, trajtat e modelet e shqipes. Ky është një tregues i qartë i punës së madhe që është bërë.

Ashtu si për terminologjitë e fushave të tjera, edhe këtu ishin për t'u zgjidhur tre probleme themelore: njësimi i terminologjisë, pastrimi i saj nga ngarkesa e tepërme me fjalë të huaja, zgjerimi e pasurimi i saj. Detyra më e vështirë, me të cilën është ndeshur dhe e ka zgjidhur komisioni hartues, ka qenë ajo e pastrimit të terminologjisë, e shqipërimit të saj. Si rrugë për zgjidhjen e saj, siç thuhet në parathënieën e përbashkët, është ndjekur kjo: "Të çfrytëzoheshin sa më shumë mundësitë e mëdha që ka gjuha jonë për fjalëterma dhe prirja që ka marrë vetiu zhvillimi i gjuhës letrare në kohën tonë". Si një kontribut i rëndësishëm duhen përmendur këtu fjalët-terma shqipe, të cilat kanë vlerë jo vetëm për terminologjinë e elektroteknikës, por edhe për mjaft fusha të tjera, p.sh. *përthithje* për absorbim, *dendësi* për densitet, *lakore* për kurbë, *gjani* për amplitudë, *njehsor* për kontaktor etj. Termat shqipe janë gjetur drejt dhe me përpikmëri prandaj, për mendimin tonë, zevendësimi i fjalëve të

huaja edhe në disa raste të veçanta mund të ishte bërë më me konsequencë. Kështu, ndërsa për *komutim* është gjetur mirë *ndërçelje*, ndeshen termat *forcë elektrolëvizore komutuese* dhe *forcë elektrolëvizore e ndërçeljes* ose e *komutacionit*. Është lënë fjala *seksion* për rus. сечение, fr. section tek *seksion dhëmbi*, kur është përdorur drejt fjala shqipe tek *përcjellës me prerje rrotullore* fr. fil a section circulaire. Zevëndësimi në përgjithësi i fjalës *seksion* në kuptim rus. сечение me *perje* do të ndihmonte detajimin më të përpiktë të termave, për ta dalluar nga *seksion* për rus. секция, një e ndarë, si tek *seksion i pëshlljelljes* fr. section du bobinage. *Dispozitiv* ruhet krahas *veglëri*, *interruptor* krahas *çelës*, mbiemrat *parësor*, *dytësor* për *primar sekondar* herë përdoren e herë jo.

Është e kuptueshme, që në këtë rrugë të re që hapet, mund të ketë edhe diçka jo fort të goditur, që pret një zgjidhje më të mirë. Për *reciprok* mutual, na duket neve, nuk tingëllojnë as i *shoqishoqëm*, as i *ndërsjellët*, siç janë përdorur tek termat *induksion* i *shoqishoqëm* dhe *induktioitet* i *ndërsjellët*. Tek termi *elektrometër me pe* (ose *me fill*) më drejt do të ishte si variant kryesor *me fill* që është më afër edhe rusishtes с катушкой, Zëvendësimi i *alternativ* me *tjetëror* është një kalkim nga forma, ndoshta mund të mbahej fjala e përdorur *rrymë e ndryshuar* si kundërvënje për *rrymë e vazhduar*.

Nganjëherë shqipërimi ndeshet në vështirësi të tjera. Për *izolim*, *izolant*, *izolator* janë gjetur mirë *veçim*, *veçues*, *veçor*. Porse ato na shtynjë që edhe foljen *izoloi* ta zevëndësojmë me *veçoj*. Në praktikën e përditëshme folja përdoret gjerësisht dhe po t'u thuhet punëtorëve: *duhen veçuar ata dy telat atje*, atëhere do të kemi keqkuptime të vazhdueshme, keqkuptime që mund të përsëriten edhe për termat e mësipërm. Kjo ngre çështjen që në pranimin e një termi të ri ka shumë rëndësi të merret parasysh edhe *fati i tij i mëtejshëm në praktikën e përditëshme*, sa do të jetë e mundur me të vërtetë të përvetësohet termi dhe si do të bëhet ky përvetësim. Këtu lozin rol edhe ana fonetike e fjalës, edhe semantika e saj, modeli i fjalëformimit, modeli i brendshëm i ndërtimit semantik (si tek rasti *tjetëror*), nuancat e ndryshme që mund të marrë fjala. Fjala *kapëz* për rus. Зажим, бонд. fr. borne, serre-fils do të shqiptohet *kapës* e që këtë do vazhdojë të mbetet *kapëse*, siç përdoret sot. Fjala *kësulë* për rus. шапка. fr. capot ruan një nuancë të kuptimit që vështirë se do t'i japë forcë për të zevëndësuar *kapuç* që përdoret.

Vështirësia tjetër është se për të njetin nocion mund të propozohen dy-tre terma dhe zgjedhja e njerit prej tyre nuk është e thjeshtë; sinonimia këtu është e padëshërueshme si me fjalët e huaja, ashtu edhe ndërmjet atyre shqipe. Do kishte qenë mirë të lehtësohej fjalori nga këto sinonime, veçanërisht atëherë kur termat sinonimë të propozuar zor se ka shpresë të përdoren, p.sh. jepet *fërkuës* për *furçë kontakti*, *kontakt me cen* për *kontakt i keq*, *nxënësi e çlqçjes* për *fuqi e çlqçjes*, *rregull e pëlqerit* për *rregull e gishtit të madh*, *rrethojë* për *qark*, *zhderdhje* për *shkarkim* etj.

Si meritë tjetër në rrugën e shqipëritmit është për t'u theksuar se, siç thuhet në parathënieën e përgjithshme, janë shfrytëzuar sa më shumë e më mirë mënyrat dhe tipat më produktivë të formimit të fjalëve në gjuhën shqipe. Kjo duket veçanërisht në përdorimin e prapashtesave sot mjaft produktive si *-im*, *-je*, *-(ë)s*, *-or*, *-shëm* etj., ose të prapashtesave si *përdër-* etj. Ndeshet vetëm një ndërtim jo shqip: *hapësirë xixë*. Ndërtimet në shqip si *kontakt urë*, *ving urë* zbrërthehen: ç'është urë ose si urë, që ka formën e urës, që shërben si urë etj. kurse *hapësirë xixë* nuk mund të marrë një interpretim të tillë e të na japë në shqip nocionin rus. искровой промежуток, fr. distance d'eclatement, distance explosive. Përdorur në termin vijues *hapësirë-xixë mbrojtëse* shpie në ngatërim, sepse në shqiptim do dëgjohet si *hapësirë xixë-mbrojtëse*, në përputhje me modelin produktiv të sotëm.

Dihet se vlerën dhe kuptimin e vet çdo term e merr nga vendi që ze në terminologjinë e caktuar, kështu që edhe kur futet një term i ri, ai duhet të lidhet organikisht me të tjerët, të përdoret njësoj në të gjitha konstruktet e rrethanat. Çdo term nuk mund të shihet si një gjë e veçantë, por vetëm si një pjesë e një të tërë të vetme. Në fjalorin e elektroteknikës vërejmë se kjo është ndjekur me konsequencë, fjalët shqipe jepen njësoj edhe si terma në vehte; edhe në termat e përberë, ku janë të varura ose pjesë përbërëse e një kompozite. Përjashtim

bën vetëm ndonjë rast i rrallë : për frëngjisht *toron* është përshtatur nga rusishtja *жила*, dhe propozohet *dell*. Porse në termat e përbërë është përdorur fjalë tjetër : *kablë me një fil* ОДНОЖИЛЬНЫЙ КАБЕЛЬ, *kordon me një fije* ОДНОЖИЛЬНЫЙ ШНУР *tel me shumë fije* МНОГОЖИЛЬНЫЙ ПРОВОД. Siç shihet, këtu për *жила*, mbetet të zgjidhej ndërmje *fill* e *fije*.

Një terminologji e punuar mirë dallohet nga termat që shënojnë nocionet themelore të lëmit përkatës e që shërbejnë si shtylla mbështetëse e të gjithë terminologjisë. Jo më pak rëndësi merret sot përpunimi i termave që shërbejnë për të shënuar të gjitha ato hollësi, detaje të imta, anë speciale që arrihen në njohjen gjithnjë e më të thellë të fenomeneve dhe në zhvillimin e vullshëm të teknikës, që krijon makina gjithnjë e më të ndërlikuara, të përbëra nga mijra e mijra detaje. Veçanërisht këtu është e vështirë të arrihet njëkuptimësia dhe përpikmëria sa më e madhe e termit, si kërkesa themelore ndaj çdo termi. Në këtë fjalor janë dhënë mjaft nga këta terma të imtë, nëse mund t'i quanim kështu : jepen mjaft bobinash-çelësash, elektromagnetësh, elementësh etj. Shumë drejt sillet *përndarje*, që e jep në shqip nuancën e nevojshme për rus. *распределение*. fr, *distribution* në vend të *shpërndarje* që përdoret gjerësisht. Ndoshta kjo mund të ishte arritur edhe në disa raste të tjera të pakta; si p.sh. *çvendosje* përdoret edhe për rus. *опрокидывание* fr. *reversement* edhe për rus. *смещение* fr. *déplacement*; tek *çvendosje* e *fazave* na duket se do të që më drejt *këmbim fazash* për ta dalluar nga *fazim*, që gjithashtu është konsideruar e barabartë me *çvendosje fazë*. *Dorëzë* është mbajtur për rus. *ручка*, fr. *bouton* dhe tek *dorëzë mbrojtëse* rus. *защитная перчатка*, fr. *gant de protection*, ku mund të zgjidhej diçka tjetër : *dorëzë*, *dorashkë*.

Tek termat e imtë del me më forcë kërkesa që termi të jetë sa më i shkurtër, për t'u përdorur sa më lehtë. Me mjaft sukses, ndër të tjera, këtu është përdorur kompozimi, si p.sh. për *sensibilitet ndaj elektricitetit* drejt propozohet *elektronlëshëm rir*. Mund ta ndihmonte këtë edhe zgjedhja nga fjalët që përdoren në praktikë, p.sh. për *bobinë me përshtjellje të shtypur* përdoret *bobinë e rrafshët*.

Hartimi i terminologjisë tekniko-shkencore arrihet me një punë të përbashkët harmonike ndërmjet gjuhëtarëve dhe specialistëve përkatës. Është për t'u lavdëruar puna e gjuhëtarëve të cilëve u është dashur të hyjnë shpesh në thelbin e problemeve teknike për të arritur tek termi i drejtë. Me një kujdes pak më të madh nga ana e specialistëve teknikë, mund të ishte shmangur ndonjë pasaktësi e vogël. Kështu *lëkundje* është dhënë për rus. *качание* dhe fr. *page*, ku fjala frënge nuk përputhet, do ketë një ngatërrim për shkak të kuptimeve të fjalës ruse. *Обратимость полюсов*, *réversibilité des pôles* duket nuk është *anasjellje e poleve*, por aftësia e poleve për t'u anasjellur, kthyeshmëria e poleve; *подзарядка батареи*, *rechargement des batteries* nuk është *ngarkim i vëzhdueshëm*, por *ringarkim i baterive të shkarkuara*; *оплетенный провод*, *fil tressé* është jo *tel i thurur* por *tel i veshur me diçka të thurur*. Lidhur me këtë është edhe zgjedhja e termave që duhen futur dhe atyre që duhen lënë jashtë. Nuk do ishte keq të mos ishin lënë jashtë terma të tillë si *volt fushë elektrike*, *impuls*, kur jepet *karakteristikë impuls*, *çelës me vaj* kur jepet *shkeputje e shumëfishit (e qarkut në çelësin e vajit)* e disa të tjerëve, ndërsa mund të lireshin jashtë disa lloj të rralla elektrodash ose ndonjë term si *autobuz elektrik*.

Gjatë punës me fjalorin lindin edhe disa çështje thjesht leksikografike, që e vlen të disku tohen. Termat mund t'u përkasin pjesëve të ndryshme të ligjëratës, kështu në fjalor jepen edhe *dal nga sinkronizmi* edhe *dalje nga sinkronizmi*, poashtu *kyç*, *kyçje*, *i kyçur*; *fikatës*, *fikatje* (ndoshta për *amortizim* mund të propozohet edhe *shutitje* e më tej *shutit*, *shutitës*). Në mjaft raste jepet vetëm emri foljor, pa foljen përkatëse ose mbiemrin; mendojmë se mund të jepen shih pak më gjërë, për të treguar mundësitë fjalëformuese të termit që propozohet, gjë me shumë rëndësi për një terminologji të re në zhvillim e sipër. Karakteristikat gramatikore të termave në përgjithësi nuk jepen, vetëm se tek emrat kemi lëkundje për trajtën e shquar dhe atë të pashquar e rrallë jepet edhe shumësi; do të ishte e udhës të mbahej një parim i caktuar, në mënyrë që të mos kemi raste si p.sh. *efekt i Voltës*, *efekt-i Tomson*, *efekt Xhoul*.

Sidomos termat e rinj që propozohet do të që më mirë të jepeshin veçan, pastaj në termat

e përbërë. Kështu të jepej veçan *frequencë* shih *denduri* dhe pastaj *frequencë e lartë*, — e ulët dhe po ashtu *denduri* ЧАСТОТА, *frequency* dhe pastaj llojet e saj; të jepej *thundër* për rus, ЦОКОЛЬ, fr. socle, pastaj *thundër çelësi*, kabli, shtyllë; mungon *thundër llampe*, e më që është rasti, të ishte gjetur diçka për portollampë rus. ПАТРОН, fr. douille. Kjo mënyrë do ta lehtësonte fjalorin nga disa përsëritje.

Në fjalor ndeshen dy fjalë që shënojnë puntorin, specialistin për një fushë ose makineri: *elektrometallurg* dhe *elektroteknik*. Nëse do të pranohet përfshirja e këtyre fjalëve në përgjithësi, ato mund të zinin më tepër vend edhe në këtë fjalor, duke përfshirë dispetçerët, bobinatorët, montuesit, teknikët e puntorët e ndryshëm të elektromotorëve, turbinave etj.

Një çështje më vehte përbën krahasimi i fjalorëve që i përkasin degëve të afërta ose që janë nëndarje të një dege apo shkence. Krahas terminologjisë së elektroteknikës është përgatitur dhe ai i elektromagnetizimit. Vëmendja kryesore këtu përqëndrohet në termat që duhet të hyjnë vetëm në njerin ose vetëm në tjetrin fjalor dhe termat që do të jenë të përsëritura. Janë përfshirë vetëm në elektromagnetizëm fjalë si *akumulator*, *central hidraulik*, tek elektroteknika është dhënë *anodë* e nuk gjejmë *katodë*.

Së fundi, dëshërojmë të ngrejmë një çështje që nuk është prekur në fjalor. Në literaturën tekniko-shkencore të sotme kudo përdoren gjerësisht shkurtimet. Në një fjalor special e kishin vendin shkurtimet për disa nga njësitë themelore si amper, volt, om, here etj. dhe për disa nocione themelore e fjalë që përdoren shpesh, si rrymë e vazhduar, rrymë alternative, forcë elektromotore, tension i lartë etj.; unifikimi i këtyre shkurtimeve do t'i sillte një shërbim shumë të madh praktikës.

Dalja në dritë e një fjalori terminologjik është një sukses i madh i arritur, por me këtë nuk mund të thuhet se është mbaruar puna. Ka përfunduar një etapë e rëndësishme dhe çelët një tjetër: propagandimi dhe përhapja e termave, verifikimi i tyre në praktikë, plotësimi dhe përmirësimi i mëtejshëm sipas vërejtjeve të atyre që do t'i përdorin çdo ditë, për të arritur përsosjen e tyre të mëtejshme, në mënyrë që ribotimi i ardhshëm të jetë një hap tjetër përpara në këtë rrugë të vështirë, por me rëndësi të paçmueshme.

Xhevat Lloshi